



Gjatë vitit 2014, vazhdon bashkëpunimi midis Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe projektit PPF (Project Preparation Facilities) financuar nga Bashkimi Europian .

Në kuadër të këtij bashkëpunimi është parashikuar të zhvillohen trajnimet me tematika si më poshtë:

1. Menaxhimi i ciklit të projektit - trajnim 3 ditor;
2. Menaxhimi i parregullsive dhe riskut- trajnim 3 ditor;
3. Hartimi i Termave të Referencës për projektet e financuara nga BE-trajnim 2 ditor;
4. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm për fondet IPA-trajnim 3 ditor;
5. Monitorimi dhe vlerësimi në menaxhimin e decentralizuar të asistencës financiare të BE –së- trajnim 2 ditor.

Trajnimet janë hartuar për anëtarë të grupeve ndërministrorë, si edhe nëpunës të cilët janë të përfshirë në këto procese.



Në vazhdim të bashkëpunimit më projektin SMEI III, janë zhvilluar disa trajnime gjatë muajit Mars 2014, të cilat kanë patur në fokus trajnimin e anëtarëve të grupeve ndër ministrorë të punës, për çështje që lidhen me kapituj të veçantë si Kapitujt e *Acquis* :1,3, 8, 11,12, 13, 14, 15, 20, 23, 24,27,28, 29, 30, 31 etj. Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan 9 ditë trajnimi dhe u trajnuan 276 nëpunës, anëtarë të këtyre grupeve.

Gjithashtu, po në kuadër të këtij bashkëpunimi po mbështetet zhvillimi i trajnimit-

“Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumenteve strukturore” - Kapitulli 22 i *Acquis* - trajnim 2 ditor

Trajnimi fokusohet në çështje si: Politikat rajonale të BE-së; funksionimi dhe impaktet e politikës rajonale; si mund të ndihmojë politika rajonale në evitimin e disproporcioneve në nivelet e zhvillimit midis rajoneve, etj. Grupi i synuar ishin anëtarët e grupeve ndërministrorë të ngritur për këtë qëllim. Ishin të ftuar edhe institucionet anëtare të IIWG 22, si edhe ekspertë nga Ministria e Integritimit Evropian dhe njësitë e IPA-s.



Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në kuadër të programit TAIEX, do të zhvillojë në datat **19-23 Maj 2014**, aktivitetin “Expert Mission Training Programmers for Senior Managers”. Objektivi kryesor do të jetë rritja e kapaciteteve të stafit të ASPA-s me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve që ajo ofron, në përputhje me nevojat reale të administratës publike shqiptare.

Objektivat specifike të këtij aktiviteti janë:

- Njohja e metodologjisë për analizën e nevojave për trajnim për menaxherët e niveli të lartë;
- Asistencë për menaxherët e trajnimit të ASPA-s, në hartimin kurrikulës së trajnimit për këtë nivel nëpunësish;
- Krijimin e burimeve të trajnimit (siç janë dokumente ose materiale, raste studimore etj);
- Krijimin e burimeve të nevojshme për e-learning ;

Po në kuadër të këtij bashkëpunimi , në **datat 29-30 Maj 2014**, do të zhvillohet workshop-i me temë: “ Rritja e kapaciteteve të stafit manaxherial në lidhje me metodologjinë e trajnimit dhe vlerësimin e procesit të trajnimit . Objektivat kryesore të këtij aktiviteti do të jenë:

- Asistencë për menaxherët e trajnimit në hartimin e kritereve, standardeve dhe rregulloreve të brendshme të institucionit;
- Eksperiencat e vendeve të tjera europiane në këtë fushë;
- Hartimi i një manuali për ekspertët;
- Vlerësimi on-line i procesit të trajnimit, dhe i ndikimit të tij në rritjen e cilësisë së punës së Administratës Publike.